

## **Shtetësia shqiptare**

### **Fitimi i shtetësisë**

#### **A) Fitimi i shtetësisë me lindje**

Çdo fëmijë që lind jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë duke pasur qoftë dhe njërin prej prindërve me shtetësi shqiptare e fiton vetiu shtetësinë shqiptare

Prindërit e fëmijës duhet të paraqiten në ambasadë për deklarimin e lindjes së fëmijës me dokumentet e nevojshme:

- Certifikatën e lindjes së fëmijës;

-

Deklaratën e prindit jo shqiptar për pëlqimin e tij që fëmija të marrë shtetësinë shqiptare.

Të dyja këto dokumente duhet të jenë të vertetuara nga autoriteti kompetent i v endit përkatës

#### **B) Fitimi i shtetësisë me natyralizim**

Fitimi i shtetësisë me natyralizim bëhet kur i huaji plotëson kushtet e përcaktu ara nga ligji për shtetësinë shqiptare:

1. Të ketë mbushur moshën 18 vjeç;

2. Të ketë banuar ligjërish në territorin e Republikës së Shqipërisë, në mënyrë të vazhdueshme, për jo më pak se 5vjet;

3. Të ketë banesë dhe të disponoje të ardhura të mjaftueshme;

4. Të mos ketë qenë ndonjëherë i dënuar (në Republikën e Shqipërisë ose në nd onjë vend tjetër) për vepra penale, për të cilat ligji parashikon dënime me jo më pak se 3vjet heqje lirie.

Përrjashtime nga ky rregull bëhet në rastet kur vlerësohet se dënimi është dhënë për motive politike.

5. Të ketë njohuri të paktën fillestare të gjuhës shqipe;

6. Me marrjen e shtetësisë të mos preket siguria dhe mbrojtja e Republikës së Shqipërisë.

**Shënim:** Republika e Shqipërisë lejon dyshtetësinë, pra për të fituar shtetësinë Shqiptare të huajt nuk janë të detyruar të lënë shtetësinë e vendeve nga vijnë.

Dokumentet e nevojshme për fitimin e shtetësisë me natyralizim:

1. Kërkesa e shtetasit të huaj drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

Kjo kërkesë duhet të përmbajë

identitetin e plotë të kërkuarit (emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje, shtetësi), adresën e saktë të vendbanimit të tijtë përhershëm dhe adresën ku pret informim për ecurinë e aplikimit të tij si dhe arsyet e kërkesës për fitimin e shtetësisë shqiptare. Kërkesa nënshkruhet nga kërkuari;

2. Mendimi me shkrim i nëpunësit që pranon dokumentet për nivelin e njohurive të gjuhës shqipe;

3. Certifikata e lindjes, origjinale dhe e legalizuar në ambasadë;

4. Leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë sipas kriterëve të ligjit për shtetësinë (fotokopje e noteruar), nëse banon në Shqipëri;

5. Akti i pronësisë së banesës ose kontrata e zënies me qira të banesës (fotokopje e noteruar);

6. Kontrata e punës për të punësuarit ose vërtetimi nga zyra e tatimeve për të vetpunësuarit ose investitorët (fotokopje e noteruar);

7. Dokumente që vërtetojnë disponimin e mjeteve financiare të mjaftueshme për jetesë, si garanci bankare, librezë kursimi, vërtetime zyrtare të ardhurash (fotokopje e noteruar);

8. Dëshmia e penalitetit e marrë në vendin e origjinës dhe në vendin ku kërkuari ka pasur qëndrim legal për gjashtë muajt e fundit;

9. Dokumenti që vërteton qenien azilant, nëse është i tillë (fotokopje e noteruar);

10. Mendimi me shkrim i komisarit të policisë vendore për sjelljen dhe qëndrimin e kërkuarit, nëse banon në Republikën e Shqipërisë;

11. Fotografia e aplikuesit, tre copë ( në rast se ka fëmijë të mitur, fotografi për secilin prej tyre);

12. Certifikata (kur është e nevojshme) për të vërtetuar origjinën shqiptare të kërkuarit, deri në dy shkallë, qoftë dhe nga njëri prind.

## Rifitimi i shtetësisë

Personi që ka hequr dorë nga shtetësia shqiptare për shkak të premtimit për fitimin e një shtetësie tjetër e rifitonshtetësinë shqiptare në qoftë se nuk ka fituar shtetësinë e premtuar. Edhe në këto raste paraqiten dokumente identifikuese si dhe dokumente që argumentojnë kërkesën për shtetësi shqiptare si më poshtë :

1. Kërkesa e qytetarit drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Kjo kërkesë duhet të përmbajë identitetin e plotë të tij (emër, mbiemër, datëlindje, vendlindje, shtetësi), adresën e saktë të vendbanimit të tij të përhershëm, adresën (nr. e tel.) ku pret informim për ecurinë e aplikimit të tij si dhe arsyet e kërkesës për rifitimin e shtetësisë shqiptare. Kërkesa nënshkruhet me emër, mbiemër e firmë nga kërkuesi;
2. Certifikata e lindjes dhe ajo familjare;
3. Relacioni shpjegues dhe konfirmimi nga komisarati i policisë vendore dhe prefektura përkatëse lidhur me shtetësinë që kanë ose kanë pasur prindërit e çdo aplikuesi;
4. Deklarata noteriale nga çdo aplikues madhor për faktin e aplikimit ose jo për të fituar shtetësi tjetër;
5. Vërtetimi i njësisë administrative përkatëse për çdo aplikues madhor;
6. Certifikata e lindjes ose e vdekjes së prindërve të çdo aplikuesi;
7. Fotografia e aplikuesit, tre copë (në rast se ka fëmijë të mitur, fotografi për secilin prej tyre).

## Heqja dorë nga shtetësia shqiptare

Lënia e shtetësisë shqiptare bëhet me dekret të Presidentit të Republikës, kurse përpunimi i kërkesës për lënien është shtetësisë bëhet nga Ministria e Brendshme.

Ligji shqiptar lejon marrjen e shtetësive të tjera, veç asaj shqiptare. Ligji shqiptar nuk lejon lënien e shtetësisë shqiptare, kur personat kërkues mbeten pa shtetësi.

Aplikimi për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare është individual, pra bëhet nga vetë personi që kërkon të heqë shtetësinë ose nga një person i afërm i autorizuar me prokurë.

Përrjashtim lidhur me këtë bëjnë të miturit deri në moshën 14 vjeç, për të cilët aplikojnë prindërit e tyre. Kurse për fëmijët e moshës 14 deri 18 vjeç, aplikimi është

individual, por duhet shoqëruar nga deklaratat noteriale aprovuese të dy prindërve. Në rast se fëmija ka vetëm një prind ose ka një kujdestar, aplikimit i bashkëlidhen dokumentet që konfirmojnë kujdestarinë mbi fëmijën.

Heqja dorë nga shtetësia shqiptare bëhet në rast se është marrë një shtetësi tjetër ose është marrë premtimi për marrjen e një shtetësie tjetër.

Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Kërkesa e shtetasit shqiptar drejtuar Presidentit të Republikës së Shqipërisë
- 2) Premtimi nga autoriteti kompetent i shtetësisë tjetër ose dokument shtetësie original, marrë në vendin përkatës;
- 3) Certifikata e lindjes e aplikuesit;
- 4) Dëshmi penaliteti;
- 5) Vërtetim nga gjykata e rrethit;
- 6) Vërtetim nga prokuroria;
- 7) Vërtetim nga zyra e përmbarimit;
- 8) Vërtetim nga kryetari i njësisë administrative që është banor i asaj njësie, në të cilën konfirmohet adresa e saktë;
- 9) Certifikatë martese e aplikuesit, nëse është i martuar;

- 10) Certifikatë e gjendjes familjare në shtetin ku banon;
- 11) Deklarata noteriale e të dy prindërve, ku të shprehet pëlqimi i tyre për heqjen dorë nga shtetësia shqiptare e fëmijëve të tyre të moshës së mitur;
- 12) Dokumenti që vërteton vendbanimin e tij në shtetin premtues të shtetësisë tjetër;
- 13) Mandat pagesa.

#### Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja e dokumentacionit me postë ose personalisht;
- 2) Verifikimi i dokumentacionit nga konsulli;
- 3) Përcjellja e dokumentacionit zyrtarisht nga përfaqësia për autoritetet përgjegjëse.

#### Tarifa e shërbimit dhe afati

30 euro /45 \$                      3 muaj

Zyra: Të gjitha përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Shënime: Të gjitha dokumentet e lëshuara në Republikën e Shqipërisë pranohen kur janë nënshkruar nga titullari i institucionit. Aplikimet për lënien e shtetësisë shqiptare janë individuale, veç atyre të shtetasve mitur, për të cilët shprehen prindërit e tyre. Dokumentacioni duhet të jetë i dy muajve të fundit. Të gjitha dokumentet (të prodhuara në Shqipëri apo në vende të tjera) pranohen kur janë në harmoni të plotë me njëri tjetrin, pa gabime e korrigjime. Të gjitha dokumentet për heqje dorë nga shtetësia sigurohen nga vetë të interesuarit. Pagesa e tarifës së shërbimit konsullor kryhet nëpërmjet bankës.

